

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8301
E premte, 15 maj 2026
Çmimi 0.50 €

ShBA-ja drejt furnizimit të Kosovës me armatim me vlerë prej 14 milionë dollarësh | FAQE 6




Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ÇFARË NDRYSHIMESH PËSUAN LISTAT E PARTIVE PËR ZGJEDHJET E QERSHORIT? | FAQE 4-5



Lista e Partisë Demokratike të Kosovës sjelli më shumë ndryshime, me kandidatë si Përpamir Gruda e Arian Tahiri që futen në pesëshen e parë.

2026	2025
1. Bedri Hamza	Bedri Hamza
2. Uran Ismaili	Uran Ismaili
3. Vlora Çitaku	Vlora Çitaku
4. Përpamir Gruda	Emver Hoxhaj
5. Arian Tahiri	Arben Mustafa
6. Besa Kabashi Ramaj	Besa Kabashi Ramaj
7. Rrahman Rama	Rrahman Rama
8. Arben Mustafa	Ensan Rrahmani
9. Sala Jashari	Sala Jashari
10. Emver Hoxhaj	Kujtim Gashi
11. Jakup Nura	Jakup Nura
12. Ganimete Musliu	Ganimete Musliu
13. Blerita Deliu Kodra	Blerita Deliu Kodra
14. Xhavit Haliti	Xhavit Haliti
15. Rrahmet Mustafa	Përpamir Gruda

Bartës të rinj, lëvizje të kandidatëve nga një parti politike në tjetrën, lënie jashtë dhjetëshes së parë të figurave të njohura partiake, madje edhe jashtë garës:

këto janë ndryshimet në listat zgjedhore të subjekteve kryesore politike shqiptare për zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të 7 qershorit. Sipas njohësit të

çështjeve politike, Artan Muhaxhiri, listat e kandidatëve për deputetë janë refleksion i dinamikave brenda subjekteve politike

AKTUALE



NË SHBA RIAFIRMOHET MBËSHTETJA PËR KOSOVËN NË NATO, DËSHTON KUSHTËZIMI NDAJ GREQISË PËR MOSNJOHJE | F. 2

MASAKRAT NË QYSHK, ZAHAQ, PAVLAN DHE LLABJAN MBETEN NDËR PLAGËT MË TË RËNDA | F. 6

QEVERIA MIRATON VENDIMIN PËR SHPRONËSIMIN E PRONAVE PËR NEVOJAT E NAVIGACIONIT AJROR | F. 6

EKONOMI




DALIN NGA MINIERA MINATORËT QË ISHIN BLOKUAR NË STANTËRÇ | F. 8

SHTRENJTOHET JETA NË KOSOVË, MALLRAT 7,5 % MË TË SHTRENJTA NË MUAJIN PRILL | F. 8

SPORT



KFF DUKAGJINI FITON PËR HERË TË DYTË RADHAZI KUPËN E KOSOVËS | F. 11



PROPOZIMI QË NDËRTESESË NË AMBASADËN AMERIKANE NË KOSOVË T'I VIHET EMRI I ENGELIT MERR APROVIMIN E PARË | F. 3

GLPS: KOSOVA PO RREZIKON HUMBJEN E FONDEVE NGA PLANI I RITJES | F. 6



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

NË SHBA RIAFIRMOHET MBËSHTETJA PËR KOSOVËN NË NATO, DËSHTON KUSHTËZIMI NDAJ GREQISË PËR MOSNJOHJE

PRISHTINË, 14 MAJ - Një propozim i kongresistit republikan amerikan, Keith Self, që Shtetet e Bashkuara të ushtrojnë presion ndaj Greqisë për ta rishqyrtuar qëndrimin ndaj Kosovës dhe për të mos i penguar për anëtarësim në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), nuk arriti ta merrte mbështetjen e kolegëve të tij në një mbledhje të Komitetit për Punë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit.

Më 13 maj, Self propozoi ndërprerjen e 1.8 milion dollarëve të paraparë për trajnime ushtarake ndërkombëtare për Greqinë për shkak të refuzimit të Athinës për ta njohur pavarësinë e Kosovës. Propozimi, në formën e një amendamenti ndaj një projektligji për mbështetje për Greqinë, u kundërshtua nga kongresistët demokratë, Gregory Meeks dhe Dina Titus, si dhe nga kryesuesi republikan i Komitetit për Punë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve, Brian Mast.

Meeks tha se projektligji synon riautorizimin e një programi me mbështetje dypartiake për Greqinë, ndërsa Titus tha se çështja e Kosovës duhet të trajtohet veçmas, e jo të lidhet me programin e trajnimeve ushtarake për Athinën. Mast, po ashtu, rekomandoi votë kundër amendamentit të Selfit.

Sipas njoftimit të Komitetit, projektligji për autorizimin e ndihmës për edukim dhe trajnime ushtarake ndërkombëtare për Greqinë - H.R. 8019 - mori aprovimin e tij më 13 maj.

Self argumentoi se mosnjohja e Kosovës nga Athina po e pengon stabilitetin në Ballkanin Perëndimor dhe rrugën e Kosovës drejt anëtarësimit në NATO. "Derisa ekzistojnë përpjekje të fuqishme të përbashkëta ushtarake midis Shteteve të Bashkuara dhe Greqisë, ajo mbetet në listën e shkurtër të katër aleatëve të NATO-s që refuzojnë ta njohin sovranitetin e Kosovës", tha Self. "Këta partnerë të NATO-s i bashkohen Kinës, Rusisë dhe



Serbisë në refuzimin për ta njohur pavarësinë e Kosovës - një partnere e ngushtë që kundërshtarët tanë refuzojnë ta njohin, sepse e dinë se Kosova është shtyllë kyç për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor", shtoi Self.

Spanja, Rumania dhe Sllovakia janë tri shtetet e tjera anëtare të NATO-s që ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Për shkak se anëtarësimi në NATO kërkon pajtimin unanimit të të gjitha vendeve anëtare, mosnjohja nga këto shtete mbetet pengesë kryesore për Kosovën.

Self paralajmëroi se rajoni i Ballkanit Perëndimor përballet me paqëndrueshmëri dhe se ndikimi rus në rajon "është i njohur dhe po rritet".

Self tha se administrata Trump ka vendosur standardin që paratë e taksapaguesve amerikanë duhet të përdoren në interesin kombëtar të Shteteve të Bashkuara dhe se kjo është një çështje themelore sot. Sipas tij, Kosova ka dëshmuar përkushtim ndaj qeverisjes demokratike, kontrollit civil mbi

forcat e sigurisë dhe bashkëjetesës shumetnike - elemente që, siç tha ai, përbëjnë argument bindës për anëtarësimin e saj në NATO. "Përderisa Greqia, Rumania, Spanja dhe Sllovakia refuzojnë ta njohin aleaten tonë ballkanike, nuk do të ketë rrugë për anëtarësimin e Kosovës në NATO", tha Self.

Ai shtoi se anëtarësimi i Kosovës në aleancë do të shërbente si kundërpeshe ndaj kundërshtarëve të Shteteve të Bashkuara dhe do të ndihmonte në parandalimin e një krize tjetër në Ballkan. "Derisa e vlerësoj kontributin aktual të Greqisë në [misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë] KFOR, stabiliteti i vërtetë në Ballkan do të forcohet nëse Kosovës do t'i jepej anëtarësimi në NATO", tha Self. Mbështetje për anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe për vazhdimin e pranisë amerikane në KFOR ka shprehur edhe kongresisti demokrat, Ritchie Torres. "Kongresi shpreson që të shohë anëtarësimin e Kosovës

në NATO, mbështetje dypartiake për të mbajtur nivelin e forcave në KFOR, dhe një proces dialogu që nuk e shpërblen Serbinë për lëshime dhe kokëfortësi", tha Benny Stanislawski, zëdhënës i kongresistit Torres, në një prononcim për korrespondentin e Radios Evropa e Lirë në Uashington, Alex Raufoglu. Self, së bashku me Torresin dhe kongresistin republikan Mike Lawler, paraqitën në fund të prillit një rezolutë në Dhomën e Përfaqësuesve, përmes së cilës kërkohet që Uashingtoni ta mbështesë anëtarësimin e Kosovës në NATO.

Ivana Stradner, nga Fondacioni për Mbrojtjen e Demokracisë në Uashington, i tha Radios Evropa e Lirë se rezoluta është "sinjal i fortë politik", sepse e afron Kosovën më shumë me NATO-n në kuptimin strategjik. Sipas saj, integrimi i Kosovës në NATO do të mbyllte një "boshllëk strategjik në Evropën Juglindore që kundërshtarët kërkojnë ta shfrytëzojnë". Rezoluta është mirëpritur nga zyrtarë në Kosovë, por është

kundërshtuar nga Serbia.

Tre kongresistët amerikanë kanë paraqitur edhe një rezolutë tjetër, po më 30 prill, përmes së cilës kërkohet që Shtetet e Bashkuara të vazhdojnë pjesëmarrjen në KFOR, misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë.

Kjo rezolutë vjen pas raportimeve dhe diskutimeve në muajt e fundit për mundësinë që Uashingtoni të rishqyrtojë praninë e trupave amerikane në misionet e NATO-s, përfshirë KFOR-in.

Pentagoni i ka thënë më herët Radios Evropa e Lirë se nuk ka ndonjë njoftim për ndryshim të vendosjes së forcave amerikane. Rreth 590 ushtarë amerikanë shërbejnë aktualisht në Kosovë në kuadër të misionit paqeruajtës të NATO-s. "Pa kapacitetet amerikane, KFOR-i humb shumicën e forcës dhe efikasitetit operacional. Kjo është e qartë në rajon. Sulmi në Banjskë ishte një përkujtues se tani është momenti më i gabuar për ShBA-në që të tërhiqet nga KFOR-i dhe nga skena globale", tha zëdhënësi i kongresistit Torres.

Ai shtoi se rezoluta për KFOR-in synon ta mbajë Kosovën në agjendën e Uashingtonit, në një kohë kur zhvillimet politike mund ta zhvendosin vëmendjen amerikane në çështje të tjera.

Kosova synon të bëhet pjesë e NATO-s dhe e Bashkimit Evropian. Por, shtetet që nuk e njohin pavarësinë e saj, të shpallur më 2008, vazhdojnë të jenë pengesë në integrimin euroatlantik të Prishtinës.

Kosova është në proces të transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri të plotë, proces që pritet të përfundojë në vitin 2028. Shtetet e Bashkuara e kanë mbështetur këtë transformim, ndërsa NATO-ja ka kërkuar që FSK-ja t'u përmbahet detyrave të saj fillestare, si reagimi ndaj krizave dhe mbrojtja civile.

Kosova blen pajisje ushtarake të prodhuara në ShBA dhe është vendi ku ndodhet baza më e madhe amerikane në Ballkan, Bondsteel.

TRUMPI I KTHEN NDERIN XI JINPINGT, E FTON ME BASHKËSHORTEN NË SHTËPINË E BARDHË MË 24 SHTATOR

WASHINGTON, 14 MAJ - Presidenti amerikan Donald Trump ka deklaruar se i ka dërguar një ftesë zyrtare presidentit kinez Xi Jinping dhe bashkëshortes së tij, Peng Liyuan, për një vizitë në

Shtëpinë e Bardhë. Sipas tij, vizita është planifikuar të zhvillohet më 24 shtator dhe synon forcimin e marrëdhënieve mes dy vendeve. "E presim me padurim këtë takim. Do të doja

gjithashtu të ngrija një doli për lidhjet e qëndrueshme dhe të pasura midis popullit amerikan dhe atij kinez", tha Trumpi. Deklarata vjen në një kohë kur Uashingtoni dhe Pekini po

kërkojnë t'i stabilizojnë marrëdhëniet e tyre pas tensioneve vitet e fundit, duke sinjalizuar një ton më bashkëpunues mes dy fuqive të mëdha.



PROPOZIMI QË NDËRTESESË NË AMBASADËN AMERIKANE NË KOSOVË T'I VIHET EMRI I ENGELIT MERR APROVIMIN E PARË



PRISHTINË, 14 MAJ - Komiteti për Punë të Jashtme i Dhomës së Përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara ka miratuar një projektligj që parasheh që një ndërtesë e Ambasadës Amerikane në Prishtinë të emërtohet "Eliot L. Engel Building", në nderim të ish-kongresistit amerikan që njihet si një nga mbështetësit më të fuqishëm të Kosovës në Uashington.

Projektligji H. R. 8562, i sponsorizuar nga kongresisti demokrat Ritchie Torres, u miratua më 13 maj në këtë komitet me 39 vota për dhe shtatë kundër. Tani projektligji duhet të kalojë në procedura të tjera në Dhomën e Përfaqësuesve dhe në Senatin Amerikan përpara se të shndërrohet në ligj.

Engel vdiq më 10 prill në moshën 79-vjeçare. Në Kosovë figura e tij u vlerësua lart, teksa Kuvendi u mblodh në një seancë të posaçme për ta nderuar kontributin e tij për vendin.

Sipas tekstit të projektligjit, ndërtesa e Kancelarisë së Shteteve të Bashkuara në Prishtinë do të njihet zyrtarisht si "Eliot L. Engel Building", ndërsa çdo referencë e mëvonshme në ligje, harta,

rregullore apo dokumente të ShBA-së do ta përdorte këtë emërtim.

Projektligji u paraqit më 28 prill nga Torres, së bashku me republikanët Michael McCaul dhe Brian Mast, si dhe demokratin Gregory Meeks. Të katër ligjvënësist kanë pasur Engelin në krye të Komitetit për Punë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve.

Kryesuesi aktual i komitetit është Brian Mast, republikan nga Florida.

Mast tha se duke pasur parasysh mbështetjen që Engeli kishte dhënë për Kosovën, duket e përshtatshme që emërtimi i ndërtesës të Ambasadës të bëhet pikërisht në Kosovë. "Si anëtar i Kongresit ai luftoi fort në vitet '90 për të mbështetur ndërhyrjen e ShBA-së dhe për t'i ndaluar mizoritë që po kryheshin ndaj shqiptarëve etnikë në Ballkan dhe më vonë punoi drejt njohjes së Kosovës nga ShBA-ja", tha ai.

Gjatë debatit për projektligjin, kongresisti demokrat Gregory W. Meeks foli për trashëgiminë politike të Engelit, i cili ishte larguar nga Kongresi Amerikan në janar të vitit 2021, pas më shumë se tri dekadash në detyrë.

Meeks tha se trashëgimia më e

madhe politike e Engelit është në shtetin e ri të Kosovës. "Elliotti ishte ndër mbështetësit më të hershëm dhe më të zëshëm që ShBA-ja dhe NATO-ja t'i mbronin kosovarët që po vuanin nga krimet e tmerrshme të luftës dhe gjenocidit nga forcat serbe", tha Meeks, duke kujtuar se ishte pikërisht Engel që kërkoi nga Uashingtoni që ta njihje pavarësinë e Kosovës, teksa tha se vazhdoi punën për drejtësi dhe llogaridhënie për viktimat e krimeve të luftës në Kosovë dhe mbarë Ballkanin Perëndimor. "Ishte dhe është trashëgimia e Engelit dhe kontributet e tij në Kosovë njihen prej kohësh, ku janë emëruar rrugë në emër të tij, madje imazhi i tij është në pulla postare. Dhe më kujtohet biseda me të lidhur me emërtimin e rrugëve në nder të tij. Ishte krenar për këtë", theksoi ai.

Ndërkaq kongresisti republikan Kieth Self, ndonëse mbështeti projektligjin, tha se Engeli do të donte që Kongresi Amerikan të bënte më shumë për Kosovën. Këtë deklaratë ai e bëri pasi në pikën paraprake të rendit të ditës, Self kishte propozuar një amendament përmes të cilit do të kushtëzohej ndihma ushtarake amerikane për Greqinë në këmbim të njohjes

së pavarësisë së Kosovës.

Greqia është në mesin e katër vendeve të NATO-s dhe pesë vendeve të Bashkimit Evropian që nuk e njohin Kosovën - gjë që paraqet pengesë të madhe për integrimin e Prishtinës në këto dy institucione. "Po, ia vlen që të emërohet një ndërtesë për nder të Eliot Engel. Por, mendoj se nëse Engeli do të ishte sot këtu, ai do të donte që ne të shkonim përtej kësaj sepse ai e kuptonte rëndësinë e Kosovës në Ballkanin Perëndimor. Dhe përderisa mendoj se ai do ta vlerësonte emërtimin e një ndërtese në nder të tij, mendoj se ai do të preferonte më shumë që ta avancojmë Kosovën në Ballkanin Perëndimor si shtyllë kyç e stabilitetit në vend të kësaj", u shpreh Self.

Eliot Engel dhe Kosova

Demokrati Eliot Engel kishte përfaqësuar një pjesë të Bronksit - lagje në qytetin e Nju-Jorkut, me një popullsi të madhe shqiptare - që nga viti 1989. Ai kishte qenë ndër mbështetësit kryesor në Kongresit Amerikan për pavarësinë që Kosova e shpalli më 2008. Kjo mbështetje e bëri atë të famshëm në Kosovë,

ndërkaq në Serbi ai ishte një figurë e diskutueshme.

Më 2020, gjatë një seance dëgjimore në Dhomën e Përfaqësuesve, Engel kishte folur për Ballkanin Perëndimor, e veçmas për Kosovën, ku kishte qëndruar disa herë. "Kam udhëtuar në çdo vend të Ballkanit Perëndimor disa herë. Jam takuar me aq shumë udhëheqës nga aq shumë parti dhe kam dashuruar larminë e pasur të kulturave, etnive dhe feve. Por, asnjë vend nuk më ka prekur zemrën më shumë se Kosova".

Engel kishte hyrë në Kongresin Jugosllavia po ndahej dhunshëm në vija etnike. Ai ishte përfshirë në shumë mosmarrëveshje rajonale përmes pozitës së tij në Komitetin e Punëve të Jashtme, duke fituar përfundimisht reputacionin si ekspert i Ballkanit.

Engeli kishte qenë ndër ligjvënësist e parë amerikan që i ka bërë thirrje administratës së Bill Clintonit të ndërhyjë, në vitin 1998, për t'i ndaluar veprimet e forcave jugosllave dhe serbe në Kosovë. Një dekadë më vonë ai ishte edhe më i zëshmi në Kongres për njohjen e pavarësisë së Kosovës nga ShBA-ja.

Betohen 39 vullnetarët e Korpusit të Paqes që do të shërbejnë në Kosovë

PRISHTINË, 14 MAJ - E ngarkuara me punë në Ambasadën e ShBA-së, Anu Prattipati, ka bërë betimin e grupit të 11-të të vullnetarëve të rinj të Korpusit të Paqes që do të shërbejnë në Kosovë. Në këtë grup janë gjithsej 39

vullnetarë, teksa trajnimi i tyre ka zgjatuar 10 javë.

Në njoftimin e Ambasadës së ShBA-së është thënë se vullnetarët do të kalojnë dy vitet e ardhshme duke mbështetur arsimin në anglisht dhe zhvillimin e komunitetit, duke forcuar

partneritetin ShBA-Kosovë, ndërsa shfaqin më të mirën e Amerikës. "Bashkohuni me ne për t'i mirëpritur vullnetarët tanë më të rinj të Korpusit të Paqes në Kosovë!", është thënë në njoftimin e Ambasadës së ShBA-së në Kosovë.





ÇFARË NDRYSHIMESH PËSUAN LISTAT E PARTIVE PËR ZGJEDHJET E QERSHORIT?

PRISHTINË, 14 MAJ - Bartës të rinj, lëvizje të kandidatëve nga një parti politike në tjetrën, lënie jashtë dhjetëshes së parë të figurave të njohura partiake, madje edhe jashtë garës: këto janë ndryshimet në listat zgjedhore të subjekteve kryesore politike shqiptare për zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të 7 qershorit.

Sipas njohësit të çështjeve politike, Artan Muhaxhiri, listat e kandidatëve për deputetë janë refleksion i dinamikave brenda subjekteve politike. Ai thotë për "Radion Evropa e Lirë" se nga përbërja e listave e nga renditja e kandidatëve në to mund të kuptohet gjendja aktuale e partive e orientimet e tyre në të ardhmen.

Muhaxheri shton se, përveç Lidhjes Demokratike të Kosovës - që mandatin e kaluar u rendit e treta - partitë e tjera "nuk kanë pasur as vullnet e as guxim" t'i reformojnë listat e kandidatëve. "Kjo është një shenjë e qartë që nuk kanë plan ta bëjnë ndonjë reformë të mirëfilltë dhe do të vazhdojnë me qasjen të cilën e kanë pasur deri më tash, pra edhe sa i përket adresimit të problemeve të qytetarëve, por edhe ofrimit të ofertave konkrete", thotë Muhaxhiri.

Pse ndryshoi renditja e kandidatëve në listat zgjedhore?

Pas përfundimit të afatit për dorëzimin e listave të kandidatëve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

subjektet publikuan listat, ku u vërejtën edhe ndryshime të renditjes së kandidatëve krahasuar me zgjedhjet e 9 shkurtit dhe 28 dhjetorit.

Në LDK, ndryshimi nis qysh në bartësin e listës: aty është vendosur ish-anëtarja e këtij subjekti dhe ish-presidentja Vjosa Osmani, dhe pas saj është kreu partiak, Lumir Abdixhiku. Lista e këtij subjekti ka pësuar ndryshime edhe në dhjetëshen e parë. Aty mungojnë dy ish-deputetët, Avdullah Hoti e Hykmete Bajrami, teksa janë përfshirë Albena Reshitaj dhe Jeta Statovci që ishin pjesë e grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje të kryeministrit në detyrë, Albin Kurti.

Para se të publikohej lista, Hoti, që më herët ka mbajtur edhe pozitën e kryeministrit, shkroi në "Facebook" se numri i vetëm që është i rëndësishëm është ai i partisë, teksa "numrat e tjerë i përcaktojnë qytetarët".

Ndërkaq, Bajrami tha se nuk paraqet problem vendosja e saj në listë pas "njerëzve që deri dje e kanë luftuar LDK-në", referencë për kandidatët që u paraqitën nga ish-presidentja Osmani, e cila më 2020 kishte ndarë rrugët me LDK-në.

Jashtë garës kanë mbetur edhe ish-deputetët e LDK-së, Driton Slemanaj, Vlora Dumoshi, Ismet Beqiri, Krenar Xhaferi e Rrezarta Krasniqi.

Për Muhaxhirin, Abdixhiku ka rrezikuar shumë me ndryshimet e bëra në listë. "Vetëm një rezultat spektakolar i LDK-së mund t'i japë të drejtë Abdixhikut, përndryshe nëse

rritja është e vogël, atëherë kjo do të shihet si një dështim i madh", thotë ai, duke shtuar se pakënaqësitë e kandidatëve në betejat e brendshme partiake, do të reflektohen në rezultatin zgjedhor.

Në Partinë Demokratike të Kosovës - që në zgjedhjet e dhjetorit u renditë parti e dytë - në dhjetëshen e parë kësaj radhe kanë hyrë ish-deputetët Përparim Gruda dhe Arian Tahiri, të cilët në zgjedhjet e fundit ishin në vendin e 15-të, respektivisht në të 30-tin. Por, jashtë dhjetëshes së parë mbeti Eman Rrahmani, e krejt jashtë garës mbeti Kujtim Gashi, që më herët ka mbajtur pozitën e ministrit. Po ashtu, nuk garon as ish-deputeti Abelard Tahiri dhe ish-kreu i Zubin Potokut, Izmir Zeqiri.

Përbërja e listës së PDK-së që udhëhiqet nga Bedri Hamza, për Muhaxhirin është rezultat i "mungesës së guximit" e të planifikimit të ndonjë reforme, teksa thotë se kjo parti është e fokusuar më shumë në Dhomat e Specializuara në Hagë, ku dy ish-krerët partiakë, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli, presin vendimin për akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. "PDK-ja ka sytë dhe mendjen drejt Hagës dhe, mbase, edhe pa një rezultat final nga Gjykata e Hagës nuk mund të pritë ndonjë reformë të mirëfilltë", vlerëson Muhaxhiri.

Ndryshime pësoi edhe lista e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e cila u rendit e treta nga partitë shqiptare në

Sa ndryshuan listat e partive me kandidatët për deputetë?

Nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare të dhjetorit të vitit 2025 në zgjedhjet e parakohshme që do të mbahen më 7 qershor 2026, lista e **Lëvizjes Vetëvendosje** ka pësuar vetëm një ndryshim në 15-shen e parë.

	2026	2025
1	Albin Kurti	Albin Kurti
2	Glauk Konjufca	Glauk Konjufca
3	Donika Gërvalla Schëarz	Donika Gërvalla Schëarz
4	Avni Dehari	Avni Dehari
5	Albulena Haxhiu	Albulena Haxhiu
6	Hekuran Murati	Hekuran Murati
7	Xhelal Sveçla	Xhelal Sveçla
8	Mimoza Kusari Lila	Mimoza Kusari Lila
9	Hajrulla Çeku	Hajrulla Çeku
10	Shqipe Mehmeti Selimi	Shqipe Mehmeti Selimi
11	Andin Hoti	Andin Hoti
12	Arben Vitia	Arben Vitia
13	Saranda Bogujevci	Saranda Bogujevci
14	Arbërie Nagavci	Arbërie Nagavci
15	Artan Konushevci	Zef Morina

votimet e dhjetorit. Tani bartës i listës është kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini, teksa kreu aktual partiak, ish-kryeministri Ramush Haradinaj, gjendet në vendin e 11-të.

Në dhjetëshen, po ashtu, kanë hyrë Avni Arifi e Burim Ramadani, ndërkaq jashtë garës kanë mbetur Pal Lekaj e Gani Dreshaj dhe Shemsedin Dreshaj.

Gjini, përveçse është bartës liste, është edhe kandidat i AAK-së për kryeministër. Për Muhaxhirin tërheqja e Haradinajt nga gara për

kryeministër është vendim i duhur, ndonëse e vlerëson si sfidues për Gjinin, i cili pritë të konfirmohet më vonë kryetar i ri i partisë. "Ndryshimi edhe i kryetarllëkut, por edhe i kandidaturës për kryeministër, e imponon këtë ndryshim edhe në terren dhe është një sfidë e madhe të cilën zoti Gjini do të duhet ta balancojë mes historisë dhe realitetit", vlerëson ai.

Lëvizja Vetëvendosje, në pushtet, ndërkaq, ka më pak ndryshime në listë dhe dhjetëshja e parë mbetet e

SHBA-JA DREJT FURNIZIMIT TË KOSOVËS ME ARMATIM ME VLERË PREJ 14 MILIONË DOLLARËSH

PRISHTINË, 14 MAJ - Departamenti Amerikan i Shtetit e ka njoftuar Kongresin Amerikan për një leje të propozuar për eksportimin e artikujve të mbrojtjes, të dhënave teknike dhe shërbimeve të mbrojtjes drejt Kosovës, në vlerë prej 14 milionë dollarësh apo më shumë, kanë thënë për "Radio Evropë e Lirë" disa burime brenda Kongresit.

Njoftimi është dërguar nga Byroja për Çështje Legjislative e Departamentit Amerikan të Shtetit, në përputhje me nenin 36(c) të Ligjit për Kontrollin e Eksportit të Armëve.

I njëjti i është përcjellë Komitetit për Marrëdhënie me Jashtë të Senatit.

Neni 36(c) kërkon që administrata amerikane ta njoftojë Kongresin për disa shitje apo leje të propozuara të artikujve dhe shërbimeve të mbrojtjes për shtetë të huaja.

Në dokumentin e Kongresit nuk jepen hollësi publike për llojin e pajisjeve apo shërbimeve që përfshihen në këtë leje.

"Radio Evropë e Lirë" i është drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës për më shumë hollësi, por ende nuk ka marrë ndonjë përgjigje nga zyrtarët e saj.

Njoftimi për furnizimin e

Kosovës me armatim të ri amerikan vjen në kohën kur kongresistë amerikanë po bëjnë thirrje që Uashingtoni ta mbështesë anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO).

Kosova nuk ka bërë ende kërkesë formale për t'u anëtarësuar në NATO, pasi përballet me pengesa të mëdha, siç është mungesa e njohjes së saj nga katër vendet anëtare: Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja.

Kosova edhe në të kaluarën ka blerë pajisje ushtarake nga Uashingtoni.

Në shkurtin e vitit 2025, Kosova pranoi dronë të blerë nga ShBA-ja. Muaj më vonë Kosova u furnizua me autoblanda të blera në ShBA.

Në vitin 2024 Kosova bëri kërkesë për blerjen e 200 raketave kundërtanke "Javelin".

Asokohe Departamenti Amerikan i Shtetit kishte konfirmuar për REL-in se vlera e raketave që Kosova kërkonte t'i blinte ishte rreth 75 milionë dollarë.

Më 2018, nga ShBA-ja, në Kosovë kishin ardhur automjete ushtarake, të tipit Humvee. Për furnizimin me 51 automjete të këtij tipi, Qeveria e Kosovës në



vitin 2018 kishte nënshkruar kontratë me kompaninë amerikane, AM General.

Dy vjet më vonë Kosova bleu edhe automjete të tjera ushtarake nga ShBA-ja, ndërkaq më 2021 qeveria amerikane i dhuroi Kosovës 55 automjete të tipit ASV (Armored Security Vehicle).

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) aktualisht është në proces të shndërrimit në ushtri. Procesi i transformimit të FSK-së në forca të armatosura nisi më 2018, pas miratimit të ndryshimeve ligjore. Ky proces pritet të zgjasë dhjetë vjet.

Shtetet e Bashkuara e kanë

mbështetur nga fillimi transformimin e FSK-së në ushtri, por jo edhe Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), e cila insiston që FSK-ja t'u përmbahet detyrave të saj fillestare, si: reagimi ndaj krizave apo mbrojtja civile.

Aktualisht FSK-ja po përgatitet të bashkohet me Forcën Ndërkombëtare Stabilizuese për Gazën, e cila është pjesë e planit për paqe në këtë rajon, të propozuar nga presidenti amerikan Donald Trump.

Një ekip i FSK-së mbërriti muajin e kaluar në Rripin e Gazës për të bërë një vlerësim të vendit ku

pritet të veprojnë trupat kosovare si pjesë e një force ndërkombëtare në territorin palestinez.

Përbërja e Forcës Ndërkombëtare Stabilizuese nuk është përcaktuar ende plotësisht por, sipas Rezolutës 2803 të OKB-së, ajo pritet të veprojë në koordinim me Izraelin dhe Egjiptin si dhe me një forcë policore palestineze të trajnuar rishtas.

Nuk është ende e qartë se kur do të dislokohe kontingjentet e para por, sipas disa raportimeve, kjo mund të ndodhë në muajin maj.

2026	2025
1. Bedri Hamza	Bedri Hamza
2. Uran Ismaili	Uran Ismaili
3. Vjola Çitaku	Vjola Çitaku
4. Përpamir Gruda	Emar Hashtaj
5. Arben Tahiri	Arben Mustafa
6. Besa Kabashi Ramaj	Besa Kabashi Ramaj
7. Rrahman Rama	Rrahman Rama
8. Arben Mustafa	Emar Hashtaj
9. Sala Jashari	Sala Jashari
10. Emar Hashtaj	Kujtim Gashi
11. Jakup Nura	Jakup Nura
12. Ganimete Musliu	Ganimete Musliu
13. Blerita Dëllu Kodra	Blerita Dëllu Kodra
14. Xhavit Haliti	Xhavit Haliti
15. Përpamir Gruda	Përpamir Gruda

2026	2025
1. Vjosa Osmani Sadriu	Lumir Abdishiku
2. Lumir Abdishiku	Kujtim Shala
3. Kujtim Shala	Hykmete Bajrami
4. Doarsa Kica Xhelili	Doarsa Kica Xhelili
5. Lutfi Haziri	Lutfi Haziri
6. Jehona Lushaku Sadriu	Avdullah Hoti
7. Albena Reshitaj	Anton Quni
8. Ulë Rugova	Jehona Lushaku Sadriu
9. Jeta Statovci	Ferid Agani
10. Anton Quni	Ulë Rugova
11. Avdullah Hoti	Xhafer Gashi
12. Hykmete Bajrami	Adelina Thaq Meta
13. Fahrije Hoti	Eldem Hyseni
14. Besian Mustafa	Besian Mustafa
15. Hashi Avdyli	Serbezë Muçaj

2026	2025
1. Ardit Gjini	Ramush Haradinaj
2. Besnik Tahiri	Besnik Tahiri
3. Time Kadrijaq	Time Kadrijaq
4. Bekë Berisha	Bekë Berisha
5. Arber Tolaj	Arber Tolaj
6. Albana Bytyqi	Albana Bytyqi
7. Burim Ramadani	Pal Lekaj
8. Anri Anri	Gani Dreshaj
9. Diellza Kukaj	Diellza Kukaj
10. Agim Çeku	Agim Çeku
11. Ramush Haradinaj	Burim Ramadani
12. Teuta Haxhiu	Teuta Haxhiu
13. Ahmet Isufi	Shemzudin Dreshaj
14. Fatmir Idrizi	Anton Demhasaj
15. Xhevahir Vilasaliu Zhunji	Xhevahir Vilasaliu Zhunji

Partia	Kandidate gra	Përqindja	Top 10	Top 50
LV	39	35.5%	4/10	19/50
LDK	39	34.5%	5/10	18/50
PDK	37	33.6%	3/10	16/50
AAK	37	33.6%	3/10	17/50

Tabela: Doruntina Bahju | Radio Evropa e Lirë - Burimi: Listat e publikuara të partive politike

pandryshuar, teksa partia garon për mandatin e katërt të Kurtit në pozitën e kryeministrit. Muhaxhiri thotë se ka pritur që lista e kësaj partie të mos ketë ndryshime të mëdha. Sipas tij, Kurti është "i patrazuar" në strukturat e partisë. "Atij i konvenon që ta bëjë një copy-paste dhe të vazhdojë në mënyrë të njëjtë siç ka qenë deri më tani, edhe pse kjo gjithsesi ndikon në cenimin e kualitetit të debatit brendapartiak, por edhe të ideve. Sepse nuk mund të pritet një gjë e tillë në një parti e cila vepron me kaq uniformitet dhe ku nuk ka asnjë indikacion se mund të ketë ndonjë ndryshim politik",

thekson Muhaxhiri. Por, disa figura të LV-së kanë mbetur jashtë garës. Aty nuk janë përfshirë ish-zëvendësministrat Hysen Durmishi, Dafina Gexha, Blerim Sallahu e Agon Dobruna. Po ashtu, nuk janë përfshirë as ish-kryetari i Leposaviqit, Lulzim Hetemi, ish-kandidatja për kryetare të Drenasit, Egzona Tërdevci, e ish-deputetët Driton Hyseni e Gramos Agusholli.

Përveç largimeve të disa figurave nga listat, në LV ka edhe emra të rinj që garojnë në zgjedhjet e qershorit. Në mesin e tyre janë zëvendësministrat në detyrë Arton Konushevc

dhe Triera Kasumi-Berisha, ish-kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar, Ragmi Mustafa e aktivistja Adelina Tërshani. Në PDK, vetë kreu i partisë, Bedri Hamza, tha se mbi gjysma e listës me kandidatë për deputetë përbëhet nga emra të rinj, duke argumentuar se ky ndryshim është "si pjesë e përkushtimit të PDK-së për t'u dhënë hapësirë kuadrove të rinj".

Në listën e kësaj partie, veç të tjerash, është përfshirë Rustem Mustafa - që më herët ka qenë deputetë, ish-deputetja e Partisë Socialdemokrate Aida Dërguti dhe ish-kryetari i Zveçanit, Ilir Peci.

Kritika për listat

Pas publikimit të listave pasuan edhe kritikën për to, veçmas për përfshirjen e disa figurave. Analisti politik Ilir Deda shkroi në rrjetet sociale se LV, PDK dhe LDK rikandiduan njerëz "që kanë manipuluar me vota më 28 dhjetor" - duke iu referuar ndryshimeve që u vërejtën në votat e disa kandidatëve për deputetë në disa parti, përfshirë edhe në PDK.

Ndërkaq Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi tha se në listën e kandidatëve për deputetë, Lëvizja Vetëvendosje ka përfshirë persona që janë të dënuar për vepra penale e të

akuzuar për korrupsion e vepra të tjera penale.

Në zgjedhjet parlamentare të 7 qershorit garojnë 18 parti politike, tri koalicionet, një nismë qytetare dhe një kandidat i pavarur.

Risi është që kësaj radhe Nisma Socialdemokrate e Fatmir Limajt nuk garon fare, teksa PDK-ja ia refuzoi kërkesën që figura të kësaj partie të përfshiheshin në listën e saj. Ndërkaq, garës i është rikthyer edhe Partia Socialdemokrate me gjithsej gjashtë kandidatë. Sipas të dhënave të KQZ-së, për 120 vende në Kuvend garojnë 917 kandidatë, nga të cilët 603 janë burra dhe 314 janë gra.

Vendoset gurthemeli i Parkut Industrial në Frashër të Mitrovicës

MITROVICË, 14 MAJ - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga ministrja në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari Lila, dhe kryetari i komunës së Mitrovicës, Faton Peci, mori pjesë në vënien e gurthemelit të Parkut Industrial në fshatin Frashër.

Kryeministri në detyrë Kurti tha se në këtë park industrial do të mund të vendosen bizneset e ndryshme nga Mitrovica dhe mbarë Kosova, por edhe investitorë të huaj, ashtu që të rritet prodhimtaria e të shtohet punësimi.

Teksa ftoi edhe bizneset nga mërgata që të investojnë, ai tha se sa më shumë që bizneset prodhojnë, aq më shumë

krijohen kushtet për rritje të eksporteve dhe për zëvendësim të importeve, për përmirësim të bilancit tregtar dhe për përparim të gjithëmbarshtëm socio-ekonomik.

Vlera e investimit është afër një milion euro, ndërsa punimet për ndërtimin e Parkut Industrial parashihet të zgjasin 150 ditë.



GLPS: KOSOVA PO RREZIKON HUMBEN E FONDEVE NGA PLANI I RITJES

PRISHTINË, 14 MAJ - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka organizuar të enjten tryezën e diskutimit me temë "Agjenda e Reformave të Kosovës: Çfarë më pas?"

Në panel morën pjesë Jeton Zulfaj, kryenegociator me BE-në dhe koordinator Kombëtar për Agjendën e Reformave, Eva Palatova, ushtruese e Detyrës së Shefes së Bashkimi Evropian, Eva Palatova, dhe Dren Puka, drejtor ekzekutiv i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Diskutimi u fokusua në hapat e ardhshëm institucionalë,

nevojën për koordinim ndërinstucional dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, partnerëve ndërkombëtarë dhe shoqërisë civile në procesin e reformave dhe integritimit evropian.

Së bashku me përfaqësues të institucioneve, Zyrës së BE-së, ambasadave dhe organizatave të shoqërisë civile, panelistët diskutuan mbi përparimin në zbatimin e Agjendës së Reformave dhe sfidat që po e përcjellin këtë proces.

Pas këtij diskutimi është zhvilluar edhe takimi i



mekanizmit N-CoMRA me organizatat anëtare të shoqërisë civile.

GLPS rithekson se ngecja e masave reformuese si pasojë e

krizës institucionale dhe mungesës së kompromisit politik po rrezikon humbjen e fondeve nga Planin e Rritjes.

Në rast të mospërbushjes së

masave të qershorit 2025 deri më 30 qershor 2026, vendi rrezikon të humbë qasjen në 68.8 milionë euro. Prandaj, GLPS u bënë thirrje aktorëve politikë ta trajtojnë më seriozisht integrimin evropian dhe Planin e Rritjes përmes bashkëpunimit institucional në interes të vendit.

Kjo tryezë u organizua në kuadër të projektit "WB Reform and Growth Monitor", i financuar nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancuar nga Open Society Foundation, dhe implementuar nga TEN - Think for Europe Network.

QEVERIA MIRATON VENDIMIN PËR SHPRONËSIMIN E PRONAVE PËR NEVOJAT E NAVIGACIONIT AJROR

PRISHTINË, 14 MAJ - Qeveria në detyrë e Kosovës ka miratuar propozim-vendimin përfundimtar për shpronësimin, në interes publik, të pronave të paluajtshme ish-shoqërore për nevojat e Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Republikës së Kosovës.

Ministrja në detyrë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe



Infrastrukturës, Fitore Pacolli, tha se ky projekt përfshin disa

zona kadastrale në komuna të ndryshme të vendit dhe ka për qëllim zhvillimin e infrastrukturës së navigacionit ajror. "I nderuar kryeministër, të nderuar ministra, unë po propozoj vendimin për miratimin e vendimit përfundimtar për shpronësimin e pronave të paluajtshme, pra ish-shoqërore, për nevojat e

Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Republikës së Kosovës. Ky projekt përfshin zonat kadastrale Vrellë e Goleshit dhe Mirenë në komunën e Lipjanit, Zatriq në komunën e Rahovecit, Mramor në komunën e Prishtinës dhe Bajgorë në komunën e Mitrovicës së Jugut. Qëllimi i këtij vendimi është krijimi i

kushteve për zhvillimin dhe funksionalizimin e infrastrukturës së navigacionit ajror, që ndërlidhet drejtpërdrejt me sigurinë ajrore, modernizimin e shërbimeve dhe avancimin e kapaciteteve strategjike të Republikës së Kosovës. Andaj kërkoj mbështetjen për miratimin e këtij vendimi", tha ajo.

DIBRANI PRITI NË TAKIM LAMTUMIRE ATASHEUN E ICITAP-IT, KIMBERLY RIFFE

PRISHTINË, 14 MAJ - Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Ismail Dibrani, priti në një takim lamtumire atasheun e ICITAP në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Kimberly Riffe. Në këtë takim, Dibrani falënderoi Riffen për përkushtimin e saj personal dhe bashkëpunimin e mbështetjen e vazhdueshme që ICITAP i ka ofruar Shërbimit Korrektues të

Kosovës gjatë viteve, duke theksuar se ky partneritet ka ndikuar drejtpërdrejt në ndërtimin e kapaciteteve profesionale, themelimin e Departamentit të Inteligjencës, forcimin e sigurisë dhe avancimin e standardeve të trajtimit në institucionet korrektuese.

Drejtori Dibrani theksoi se ky bashkëpunim dhe kjo mbështetje ka kontribuar ndjeshëm në përmirësimin dhe avancimin e



Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe madje në vitin e kaluar është vlerësuar me Çmimin Ndërkombëtar të Ekselencës nga Shoqata Ndërkombëtare e Korrektive dhe Burgjeve, ICPA. Dibrani e përmendi edhe anëtarësimin në shoqatat ndërkombëtare si një hap i rëndësishëm që e ka pozicionuar Kosovën në nivelin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën korrektuese, duke forcuar

shkëmbimin e praktikave më të mira dhe standardeve profesionale.

Në fund të takimit, drejtori Dibrani shprehu mirënjohje të veçantë për mbështetjen e vazhdueshme të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara, duke ritheksuar përkushtimin e institucionit për të vazhduar në rrugën e avancimit dhe të qenit model suksesi për vendet e rajonit dhe më gjerë.

Kadetët e FSK-së, pjesë e forumit për të drejtën humanitare në Itali

PRISHTINË, 14 MAJ - Qendra për Studime Universitare (QSU) ka marrë pjesë për herë të dytë në forumin ndërkombëtar "International Humanitarian Law", i mbajtur në Sanremo të

Italisë. Sipas njoftimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), ky aktivitet ndërkombëtar mbledh kadetë nga akademi të ndryshme ushtarake nga e gjithë bota, me qëllim të shkëmbimit të

njohurive dhe aftësive në fushën e të drejtës ndërkombëtare humanitare. "Qendra për Studime Universitare mbetet e përkushtuar në mbështetjen e kadetëve për të qenë pjesë e

iniciativave që avancojnë njohuritë, përvojën dhe përfaqësimin sa më dinjitoz të FSK-së në arenën ndërkombëtare", ka njoftuar FSK-ja.



SUPREMJA E SHFUQIZON NJË UDHËZIM QË I DETYRONTE SHOQËRUESIT E PACIENTËVE NË QKUK TË PAGUANIN TARIFË

PRISHTINË, 14 MAJ - Gjykata Supreme e ka shfuqizuar të paligjshëm një udhëzim administrativ të Ministrisë së Shëndetësisë i cili i detyronte shoqëruesit e pacientëve në spitalin më të madh publik të Kosovës të paguanin një tarifë prej 3 eurove për t'iu qëndruar atyre pranë.

Në një njoftim për medie të mërkurën, gjykata tha se ministria përmes këtij udhëzimi më 2024 kishte tejkaluar autorizimin ligjor të dhënë nga Ligji për Shëndetësi, duke krijuar një detyrim të ri financiar pa bazë të qartë ligjore dhe në kundërshtim me parimin e legalitetit.

Shumë kosovarë detyrohen t'i shoqërojnë të afërmit e tyre të sëmurë gjatë qëndrimit në spital

për shkak se sistemi shëndetësor vazhdon të përballet me trysi si pasojë e burimeve të kufizuara dhe emigrimit të stafit mjekësor. Disa qytetarë me të cilët kishte folur Radio Evropa e Lirë në fund të shkurtit, ishin ankuar për barrë të dyfishtë, të kujdesit dhe të pagesës në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Mesatarisht, rreth 300 infermierë largohen çdo vit nga Kosova, kryesisht drejt vendeve të Bashkimit Evropian, në kërkim të pagave më të larta dhe kushteve më të mira të punës.

Me largime të tilla janë përballur edhe spitalet rajonale të Kosovës. Largimet i kanë kufizuar kapacitetet e sistemit dhe ka rritur barrën mbi stafin e mbetur por, në mënyrë indirekte, edhe mbi familjarët e pacientëve.



Si është gjendja në spitalet e vendeve të BE-së?

Në shumicën e spitaleve në Evropë familjarët kanë të drejtë t'i vizitojnë pacientët gjatë orave të caktuara, ndërsa qëndrimi jashtë këtyre orave kërkon leje të veçantë nga stafi mjekësor.

Shumë spitale kanë politika që lejojnë përfshirjen e familjarëve në kujdes, por kjo është kryesisht për

mbështetje emocionale dhe komunikim, jo për zëvendësimin e stafit profesional. Sipas një publikimi të Revistës Evropiane për Shëndetin Publik, rreth 52 % e spitaleve evropiane kanë politika që lejojnë qasje të familjarëve edhe 24 orë, nëse pacienti dëshiron.

Vendimi i Supremes të mërkurën vjen pas një padie të ushtruar nga organizata joqeveritare, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), ndaj Ministrisë së Shëndetësisë.

IKD-ja e kontestoi në gjykatë ligjshmërinë e dispozitave të udhëzimit administrativ përmes të cilave ishte përcaktuar pagesa prej tre eurove për çdo ditë qëndrimi në spital për secilin shoqërues të pacientëve mbi moshën 15-vjeçare.

Në ankesë, IKD-ja kishte argumentuar se Ligji për Shëndetësi e definojnë bashkëpagesën si mjet financiar

që paguhet për shërbime të kujdesit shëndetësor nga personat që i shfrytëzojnë ato shërbime, ndërsa personi shoqërues nuk mund të konsiderohet shfrytëzues i shërbimeve shëndetësore, pasi ai nuk i nënshtrohet trajtimit mjekësor dhe nuk përfiton shërbime diagnostike, terapeutike apo rehabilituese.

Supremja tha se, pas shqyrtimit të provave dhe të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, ka ardhur në përfundim se dispozitat e kontestuara nuk kanë bazë të mjaftueshme ligjore

dhe se përmes tyre është zgjeruar në mënyrë të palejuar nocioni i "bashkëpagesës".

Gjykata vendosi se bashkëpagesa mund të vendoset vetëm ndaj personave që janë përfitues të drejtpërdrejtë të një shërbimi shëndetësor, pra jo edhe ndaj shoqëruesve të pacientëve. "Sipas vlerësimit të Gjykatës, personi shoqërues nuk e plotëson këtë kriter, pasi prania e tij në institucionin shëndetësor lidhet me mbështetjen e pacientit dhe jo me marrjen e shërbimeve shëndetësore", thuhet në vendim.

MASAKRAT NË QYSHK, ZAHAQ, PAVLAN DHE LLABJAN MBETEN NDËR PLAGËT MË TË RËNDA

PEJË, 14 MAJ - Në 27-vjetorin e masakrës së Qyshkut, Zahaqit dhe Pavlanit, liderë institucionalë dhe partiakë kanë bërë homazhe, duke theksuar se masakrat në Qyshk, Zahaq, Pavlan e Llabjan mbeten ndër plagët më të rënda që ka përjetuar populli ynë.

U. d. presidentja Albulena Haxhiu ka nderuar martirët e Qyshkut, Zahaqit dhe Pavlanit, 82 civilë shqiptarë të vrarë më 14 maj 1999 nga forcat serbe. "Atë mëngjes Qyshku, Zahaqi dhe Pavlani u goditën si pjesë e një operacioni të organizuar të forcave ushtarake, policore dhe paramilitare serbe. Gratë, fëmijët dhe të moshuarit u dëbuan nga shtëpitë, ndërsa burrat u ndanë, u plaçkitën, u mbyllën në shtëpi dhe u vranë. Më pas, shtëpitë u dogjën për t'i mbuluar gjurmët e krimit".

"Në këto fshatra u goditën

njerëz të paarmatosur, banorë e mysafirë që lufta i kishte gjetur aty. U shuan jetë, u prekën familje të tëra, u dogjën shtëpi dhe u dëbuan civilë shqiptarë nga vendi i tyre. Qyshku, Zahaqi dhe Pavlani mbeten dëshmi e një mizorie të planifikuar, e një aparati shtetëror që e ktheu vrasjen e shqiptarëve në metodë lufte dhe dëbimin në qëllim politik. Drejtësia për këto masakra është detyrim ndaj familjeve, ndaj të mbijetuarve dhe ndaj Republikës sonë. I përhershëm qoftë kujtimi për martirët e Qyshkut, Zahaqit dhe Pavlanit", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se masakrat në Qyshk, Zahaq, Pavlan e Llabjan mbeten ndër plagët më të rënda që ka përjetuar populli ynë. "102 shqiptarë të paarmatosur u ekzekutuan pa mëshirë nga



njësitet ushtarake e policore të shtetit serb, si hakmarrje ndaj humbjeve që po pësonin në frontet e luftës. Sot, në këtë përvjetor, kujtuam dhe nderuam edhe eprorët e luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga kjo anë e Dukagjinit, të rënë në betejë të ndryshme për liri: Skender Çekun nga Qyshku; Jahë Kabashin, Blerim e Bekim Kelmendin, si dhe Rifat Veselin nga Llabjani", ka theksuar ai. Ish-presidentja Vjosa Osmani, pasi ka bërë homazhe ka thënë se masakra e Qyshkut dhe ajo e Pavlanit mbeten nga krimet më mizore të planifikuara dhe ekzekutuara nga Serbia për të shfarosur shqiptarët e Kosovës. "Serbia duhet të përballet me të vërtetën dhe të japë përgjegjësi të plotë para drejtësisë. Lavdi e përjetshme martirëve e dëshmorëve të Qyshkut e të Pavlanit që ranë për lirinë e Kosovës!", ka thënë Osmani.

DALIN NGA MINIERA MINATORËT QË ISHIN BLOKUAR NË STANTËRG

MITROVICË, 14 MAJ - Tetëmbëdhjetë minatorët, që ishin ngjuar për disa orë në minierën e Stantërgut, kanë dalë nga miniera, konfirmoi për mediet Gani Osmani, përfaqësues i Sindikatës së Punëtorëve të Trepçës. Minatorët ishin bllokuar qindra metra nën tokë që nga ora 01:30 e mëngjesit të 14 majit, njoftoi më herët gjiganti metalurgjik Trepça, pasi kishte pasur ndërprerje të energjisë elektrike. Ndërmarrja tha se në momentin e ndërprerjes së rrymës në minierë ishin 47 punëtorë, teksa 29 prej tyre arritën të largoheshin dhe të dilnin mbi sipërfaqen e tokës. "Sipas informatave nga terreni, në hyrje të trafostacionit në flotacion është shkëputur një përcjellës i linjës, ndërsa si pasojë janë dëmtuar izolatorët përcjellës, duke shkaktuar djegie në trafon që furnizon flotacionin me energji elektrike. Po ashtu, janë evidentuar dëmtime edhe në stabilimentet tjera përcjellëse në trafostacion", u tha në njoftim. Ndërmarrja tha se punëtorët e

bllokuar në Stantërg që gjendet afër Mitrovicës janë të sigurt, teksa ekipet po punojnë për rikthimin e furnizimit të energjisë elektrike. Më herët Osmani nga Sindikata e Punëtorëve të Trepçës tha se ekipi i shpëtimit është në gjendje gatishmërie, ekip që funksionon në kuadër të kombinatit. "Jemi duke komunikuar me minatorët, gjendja e tyre është stabile. Ekipi është gati për reagim apo për t'iu dërguar ushqim, por pritet që shpejtë të rregullohet problemi me energji elektrike", deklaroi më herët ai. Sipas Osmanit, ekipet e Trepçës dhe Kompanisë për Distribuim të Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS), po punonin për të ndrequr problemin në mënyrë që të minatorët të dalin në ashensorë. "... sepse për të dalë në këmbë terreni është i papërshtatshëm. Janë mbi 800 metra përpjetë, shkallë, ka shumë pluhur, nuk është lehtë të dilët në këmbë", u shpreh ai. Edhe në të kaluarën në minierat e Trepçës ishin ngjuar minatorë



për shkak të problemeve me energji elektrike, por edhe telasheve të tjera. Shembull, më 2023 për shkak të një defekti të energjisë elektrike në një ashensor, disa minatorë kishin

mbetur qindra metra nën tokë për disa orë. Kompleksi metalurgjik Trepça është shoqëri aksionare: 80 për qind e aksioneve janë të Qeverisë së Kosovës, 20 për qind janë të

punonjësve të kësaj ndërmarrjeje. Sindikatat e minatorëve shpesh janë ankuar se minatorët punojnë pa mjete adekuate pune dhe në kushte të rrezikshme.

SHTRENJTOHET JETA NË KOSOVË, ÇMIMET RRIJEN PËR 7,5 % NË MUAJIN PRILL

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 14 MAJ - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka njoftuar se indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte më i lartë në një mesatare prej 7,5 % në muajin prill 2026, krahasuar me muajin prill 2025. Inflacioni mujor ishte 1,1 % në muajin prill 2026. Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) është rritur me 7,5 % në muajin prill 2026 krahasuar me muajin prill 2025. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të ndikuara te grupet kryesore të COICOP-it: transport (16,1 %); strehim, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse (15,2 %); restorante dhe shërbime akomodimi (5,8 %); ushqim dhe pije joalkoolike (5,6 %); pije alkoolike, duhan dhe narkotikë (5,1 %); shëndetësi (4,7 %); kujdes personal, mbrojtje sociale dhe

mallra e shërbime të ndryshme (3,6 %); mobile dhe pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje rutinore (3,1 %); rekreacion, sport dhe kulturë (3 %); dhe veshje dhe këpucë (2,3 %). Ndërkohë, rënie e çmimeve është regjistruar në grupin e informacionit dhe komunikimit (-0,2 %) dhe të arsimit (-0,6 %). Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) është rritur për 1,1 % në muajin prill 2026 krahasuar me muajin mars 2026. Rritja është ndikuar nga grupet kryesore të COICOP-it: transport (4,9 %); pije alkoolike, duhan dhe narkotikë (1,2 %); rekreacion, sport dhe kulturë (0,4 %); mobilie dhe pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje rutinore (0,3 %); ushqim dhe pije joalkoolike (0,1 %); dhe veshje dhe këpucë (0,1 %). Ndërkohë, rënie e çmimeve është regjistruar te grupi i kujdesit personal, mbrojtjes sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme (-



0,2 %). Ish-deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka thënë se sot problemi më i madh i çdo familjeje në Kosovë janë çmimet e larta. "Nuk ka rëndësi a je student, punëtor, pensionist apo i papunë. Të gjithë e ndiejnë të njëjtën barrë: paga nuk po mjafton, pensioni nuk po mjafton, thjesht të ardhurat mujore nuk i mbulojnë

më shpenzimet mujore. Disa ndihmohen prej familjarëve nga jashtë. Disa po detyrohet të marrin kredi. Të tjerë po hyn në borxhe vetëm për ta kaluar muajin. E ndërkohë, çmimet nuk po ndalen. Në prill, inflacioni në Kosovë ka arritur në 7,5 %, ndërsa në eurozonë rreth 3%, e në vendet përreth nesh nën 4 %. Pra, qytetarët e Kosovës po përballen

me rritje shumë më të madhe të çmimeve sesa qytetarët në rajon dhe ata në Bashkimin Evropian. Për ironi të fatit, ne qeverisemi tash e 6 vjet nga një njeri që ka ardhur në pushtet me premtimin se do t'i ulë çmimet. Por sot realiteti është krejt tjetër. Çmimet janë rritur. Jeta është bërë më e shtrenjtë. Familjet janë varfëruar. Premtimet kanë mbetur vetëm fjalë. Prandaj, më 7 qershor, qytetarët duhet t'i ndëshkojnë me votë ata që nuk e mbajtën asnjë premtim", ka thënë Bajrami. Ajo ka theksuar se LDK-ja ka programin më serioz për përballje me inflacionin, për mbrojtjen e familjeve dhe për kthimin e zhvillimit ekonomik si prioritet numër një të qeverisë. "Më 7 qershor vota nuk është vetëm për një parti. Është për bukën e përditshme, për familjen dhe për dinjitetin e qytetarit. Koha të ndëshkohen ata që premtuan ulje çmimesh", ka thënë Bajrami.

Takim me rëndësi strategjike për forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe rrjetëzimin e shqiptarëve në botë

PRISHTINË, 14 MAJ - Presidenti i Komunitetit të Bizneseve Kosovaro-Gjermano-Zvicerane, Shkelzen Jusaj, zhvilloi një takim pune me Shkelzen Sulejmani, nga U-SAMIL për Ballkanin, si dhe me Florim Rullani nga Oda Ekonomike Shqiptare dhe Institutit "Lidhja Shqiptaro-Europiane". Në kuadër të këtij takimi u diskutuan mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit ndërinsti-

tucional dhe ekonomik, me theks të veçantë në fuqizimin e rrjetëzimit të shqiptarëve në diasporë, promovimin e partneriteteve strategjike dhe krijimin e platformave të përbashkëta për zhvillim ekonomik, investime dhe avancim profesional. Bashkëpunimi u përqendrua gjithashtu në rëndësinë e koordinimit ndërmjet organizatave dhe komuniteteve

shqiptare në Evropë dhe më gjerë, me synim unifikimin e potencialit shqiptar në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe rritjes së pranisë së bizneseve shqiptare në tregjet ndërkombëtare. Ky takim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt thellimit të bashkëpunimit dhe ndërtimit të urave të reja lidhëse ndërmjet institucioneve, bizneseve dhe diasporës shqiptare.



ANALIZA E CNN: ÇFARË NUK MUND TË RREGULLOJË VIZITË E TRUMPIT NË KINË

Pak marrëdhënie në botë janë më të rëndësishme sesa ajo midis Shteteve të Bashkuara dhe Kinës. Vendimet që marrin këto dy superfuqi për tregtinë, inteligjencën artificiale, ndryshimet klimatike dhe çështjet e luftës e paqes do të formësojnë të ardhmen e njerëzimit në mënyra të thella. Për momentin, kjo marrëdhënie nuk është aspak e mirë, për ta thënë butë. Kjo është arsyeja pse të gjithë po i kushtojnë kaq shumë vëmendje vizitës së Presidentit Trump në Pekin këtë javë, e para nga katër takime të mundshme me Presidentin kinez Xi Jinping gjatë këtij viti. Aksionet nuk mund të ishin më të larta.

Presidenti Trump u prit me ceremoni madhështore teksa u takua me Xi Jinping në zemër të Pekinit këtë mëngjes. Një bandë ushtarake luajti himnin amerikan "The Star-Spangled Banner". Një grup fëmijësh kërcenin dhe brohorisnin për të, duke valëvitur lule dhe flamuj amerikanë.

Brenda Sallës së Madhe të Popullit, fjalët hapëse të Trumpit ishin shumë të ngrohta. "Do të kemi një të ardhme fantastike së bashku," tha ai.

"Kemi shkuar mirë edhe kur ka pasur vështirësi, i kemi zgjidhur," i tha Trump liderit kinez. "Ju jeni një lider i madh. Ndonjëherë njerëzve nuk u pëlqen kur e them këtë, por unë e them gjithsesi, sepse është e vërtetë."

Ky është një ndryshim i madh nga zemërimi që Trump shprehte gjatë fushatës elektorale dhe mandatit të tij të parë presidencial, kur thoshte se nuk do ta lejonte Kinën "të përdhunonte vendin tonë" dhe premonte ta bënte Kinën të paguante për vendet e punës dhe industrinë që SHBA-ja ka humbur.

Megjithatë, pritshmëritë për samitin mbeten të ulëta. Ka të ngjarë të ketë disa fitore afatshkurtra dhe pragmatike, si blerjet kineze të produkteve bujqësore amerikane, përfshirë mishin e viçit, si edhe akses më të madh në treg për bankat amerikane. Por nuk pritet që kjo të sjellë një ndryshim domethënës në një marrëdhënie që prej kohësh ka qenë e trazuar.

Më e mira që mund të shpresojë kushdo, thonë ekspertët, është që të dy liderët të sinjalizojnë stabilitet. Sepse, pavarësisht theksit që Trump vendos mbi "miqësinë" e tij



me Xi-n, pothuajse çdo gjë që po bën administrata Trump i ka vendosur dy vendet në rrugën drejt një marrëdhënieje më të keqe, jo më të mirë.

Një garë drejt vetë-mjaftueshmërisë

Partia Komuniste në pushtet në Kinë prej kohësh është e përqendruar te mbrojtja e vendit nga krizat gjeopolitike. Ajo po përdor subvencione dhe mbështetje shtetërore për t'i dhënë përparësi vetë-mjaftueshmërisë në energji, teknologji dhe zinxhirët e furnizimit aty ku është e mundur, dhe po sigurohet që burime kritike si nafta, soja dhe çipat më të avancuar të jenë të disponueshëm në mënyrë të qëndrueshme aty ku kjo nuk është e mundur. Qeveria kineze i ka dyfishuar këto përpjekje që kur Trump e vuri Pekinin në shënjestër gjatë mandatit të tij të parë presidencial. Siç e shprehu Xi në një ese të vitit 2020, qëllimi është të tërhiqen "zinxhirët industrialë ndërkombëtarë në një varësi më të ngushtë ndaj Kinës", për të "formuar një aftësi të fuqishme për t'iu kundërvënë dhe penguar çdo

ndërprerje të qëllimshme të furnizimeve nga aktorë të jashtëm".

Trump mund ta ketë zbutur retorikën e tij. Por mandati i tij i dytë megjithatë është përcaktuar pikërisht nga këto lloj ndërprerjesh, disa më të qëllimshme se të tjerat. Lufta tregtare e Trumpit, rrëzimi i liderit të Venezuelës dhe fushata ushtarake në Iran e kanë goditur Kinën aty ku i dhemb më shumë.

Lufta tregtare ka qenë sulmi më i drejtpërdrejtë ndaj interesave kineze. Ndërsa Trump ka tërhequr disa tarifa mbi mallrat kineze përpara samitit të kësaj jave, zyrtarët e tij tregtarë po ndjekin diçka edhe më antagoniste. Ata kanë përdorur sanksione dhe marrëveshje tregtare për të detyruar kompani dhe vende të largojnë Kinën nga zinxhirët e tyre të furnizimit dhe për të ndaluar eksportin e burimeve kritike që Kina ka nevojë, si çipat amerikanë.

Kina tani po kërcënon me veprime ligjore ndaj atyre që respektojnë kërkesat e SHBA-së dhe po lëviz më shpejt për t'u bërë e pavarur në fusha si inteligjenca artificiale.

Kapja e presidentit të Venezuelës, Nicolás Maduro,

nuk ishte, nga këndvështrimi i administratës

Trump, kryesisht e drejtuar kundër Kinës. Por gjithsesi ajo e zemëroi Pekinin. Jo vetëm që operacioni ndodhi vetëm disa orë pasi i dërguari special i Kinës për Amerikën Latine u takua me Maduron, por Kina e pa atë si një sulm ndaj një burimi afatgjatë të naftës së lirë dhe si një kërcënim për lëndë të tjera të para në Amerikën Latine, si bakri dhe litiumi.

Së fundi, sulmi amerikano-izraelit ndaj Iranit dhe vrasja e udhëheqësit suprem iranian vunë në rrezik edhe burimin tjetër të naftës së lirë për Kinën. Bllokada që pasoi në Ngushticën e Hormuzit, përmes së cilës kalon një e pesta e furnizimit botëror me naftë, ka rritur çmimet e naftës dhe ka dëmtuar ekonominë tashmë të dobësuar të Kinës. Kina është shumë më pak e varur nga nafta e huaj sot sesa një dekadë më parë, por mbetet ende blerësi më i madh në botë.

Në të tre rastet, Pekini i ka dënuar këto veprime në konferencat e përditshme dhe javore për shtyp, duke i quajtur akte "bullizmi" dhe shkelje të së drejtës ndërkombëtare.

Një cikël i rrezikshëm?

Armëpushimi i brishtë mes SHBA-së dhe Kinës ka mbijetuar, por presioni po rritet nga të gjitha anët. Shumica e ekspertëve presin një raund të ri përshkallëzimesh dhe tarifash hakmarrëse menjëherë pas këtij takimi.

Me Trumpin, sigurisht, parashikimet janë gjithmonë të vështira. Por rreziku është që të dy vendet po hyjnë në një spirale që ushqen vetveten.

Veprimet e Uashingtonit për të minuar sigurinë ekonomike të Kinës kanë ndezur alarmin në Pekin, duke e shtyrë Kinën të përshpejtojë përpjekjet për të siguruar zinxhirët e furnizimit (dhe gjithashtu për t'i përdorur ato kundër kundërshtarëve të saj). Ajo po e bën këtë pjesërisht duke prodhuar më shumë brenda vendit. Kjo, nga ana tjetër, do t'i shtyjë kompanitë kineze të eksportojnë më shumë, gjë që do të rrisë tensionet gjeopolitike dhe do të shkaktojë një reaktion të ri politik kundërpërgjigjesh.

Këto dinamika janë të vështira të ndalen sapo të kenë nisur. Dhe sigurisht do të duhet më shumë sesa fjalë miqësore dhe disa marrëveshje për sojë dhe avionë.

E IZOLUAR DHE ME FITOREN E MUNGUAR NË UKRAINË: SI HUMBI RUSIA MIQTË DHE NDIKIMIN GLOBAL



Që nga nisja e pushtimit të tij në shkallë të plotë të Ukrainës më shumë se katër vjet më parë, presidenti rus Vladimir Putin jo vetëm që dështoi të arrijë fitoren ushtarake që e dëshironte.

Ai gjithashtu ka minuar një sërë marrëdhëniesh të tjera që i ndërtoi për dekada me radhë, duke e lënë Rusinë më të izoluar se sa ka qenë që nga ditët e para të Revolucionit Bolshevik. Vetëm pushtimi i Ukrainës mjaftoi për të futur një çekan midis Rosisë dhe aleatit të saj, Kazakistanit.

Për më tepër, Putini ka një histori në zvogëlimin e bazave të Kazakistanit për shtetësi të pavarur dhe në sugjerimin se populli i tij dëshiron lidhje më të ngushta me Rusinë—pretendime që jehonin ato që Putini bën për Ukrainën. Kështu, pas pushtimit të vitit 2022, presidenti kazak Kassym-Jomart Tokayev refuzoi kërkesat e Kremlinit për ndihmë, dhe më vonë i tha Putinit se Kazakistani nuk do të njohte rajonet separatiste të mbështetura nga Rusia në Ukrainë.

Ai gjithashtu nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi ushtarak me Turqinë, duke u bërë anëtar i parë i Organizatës së Traktatit të Sigurisë Kolektive (CSTO), e udhëhequr nga Rusia, që krijon një marrëveshje të tillë me një anëtar të NATO-s.

Ndërsa marrëdhënia e Putinit me Tokayev është përmirësuar që atëherë, kjo ndoshta pasqyron faktin se të dyja palët ende kanë nevojë për njëra-tjetrën.

Pastaj është Armenia. Kur Azerbajxhani nisi një operacion ushtarak në shtator 2023 për të marrë nën kontroll Nagorno-

Karabakun, enklavën etnike armene brenda territorit të tij, paqeruajtësit rusë të stacionuar atje nuk bënë asgjë, dhe e gjithë popullsia e enklavës—rreth 100 mijë njerëz—u detyrua të largohej.

Brenda një viti, Armenia kishte njoftuar planet për t'u tërhequr nga CSTO-ja dhe po blinte armë nga Franca dhe India. Rusia tërhoqi paqeruajtësit e saj nga rajoni përpara afatit.

Kremlini gjithashtu arriti të prishte marrëdhëniet me Azerbajxhanin, i cili përfitoi nga tradhtia ndaj Armenisë. Në dhjetor 2024, një raketë sipërfaqe-ajër ruse goditi një avion pasagjerësh të Azerbajjan Airlines, duke vrarë 38 persona. Presidenti azerbajxhanas Ilham Aliyev kërkoi kompensim dhe përgjegjësi nga Kremlini, por Putini refuzoi të pranojë fajin për gati një vit. Ndërkohë, Aliyev e injoroi Putinin duke mos marrë pjesë në paradën vjetore ruse të Ditës së Fitores së Luftës së Dytë Botërore në maj 2025; forcat speciale ruse kryen një sulm vdekjeprurës kundër azerëve etnikë në Jekaterinburg; dhe Azerbajxhani sulmoi zyrën e Sputnikut, mediumit shtetëror rus, në Baku, duke arrestuar stafin e tij.

Por Azerbajxhani shërben si një korridor tregtar thelbësor drejt Iranit, i cili, deri në nisjen e luftës nga Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli në shkurt, po furnizonte Rusinë me dronë dhe raketa balistike për luftën e saj në Ukrainë.

Për të mbajtur korridorin të hapur, Kremlini u detyrua të gëlltiste ofendimin nga Azerbajxhani, dhe në tetor 2025, Putini më në fund pranoi se

sistemet ruse të mbrojtjes ajrore kishin rrëzuar avionin dhe bëri një ofertë të paqartë për kompensim.

Ndërsa kjo kërkimfalje pro-forma hapi rrugën për rivendosjen e marrëdhëniesh, episodi përbënte një gabim të madh në politikën e jashtme për Rusinë. Nga carët e sovjetikët, udhëheqësit e Kremlinit për shekuj me radhë kishin menaxhuar me mjeshtëri tensionet midis Armenisë dhe Azerbajxhanit.

Megjithatë, që nga nisja e luftës së tij në Ukrainë, Putini ka arritur të përkeqësojë marrëdhëniet me të dyja palët. Në Siri, Rusia kaloi gati një dekadë duke mbajtur në këmbë regjimin e Bashar al-Asadit, duke kryer sulme ajrore dhe duke dislokuar forca tokësore kundër forcave kryengritëse, ndërkohë që i siguronte Asadit mburojë diplomatike në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Në këmbim, Rusia ruajti kontrollin mbi bazën detare të Tartusit dhe bazën ajrore të Hmeimimit.

Por në nëntor 2024, forcat kryengritëse siriane nisën një ofensivë surprizë, ndaj së cilës ushtria ruse—e lodhur nga lufta në Ukrainë—nuk mundi të përgjigjej në masë të madhe. Brenda pak ditësh, ranë Aleppo dhe Damasku, dhe Asadi u arratis në Moskë.

Për të gjithë atë investim, Rusia përfundoi me asgjë.

Historia e tejkalimit të kufijve nga Rusia në Afrikë është po aq

e turpshme. Para luftës në Ukrainë, mercenarët e Grupit Wagner po zgjerorin ndikimin rus në të gjithë kontinentin, duke shkëmbyer kontrata sigurie për besnikëri politike dhe të drejta për minierat.

Në Mali, për shembull, ata u pozicionuan si mbështetje thelbësore për juntën ushtarake në luftën e saj kundër forcave xhihadiste.

Por në vitin 2024, rebelët Tuareg bënë pritë një konvoj të ushtrisë së Malit dhe Wagner-it pranë Tinzaouatenit, duke vrarë dhjetëra mercenarë rusë. Më pas, xhihadistët sulmuan aeroportin dhe akademinë kombëtare të xhandarmërisë në Bamako. Narrativa se Wagner po e bënte Malin më të sigurt ishte bërë e papranueshme.

Ndërsa disa forca, të riemërtuara si “Korpusi i Afrikës”, mbetën pas pasi Wagner u largua zyrtarisht nga Mali në qershorin e kaluar, edhe ato tani janë tërhequr.

Gjërat nuk janë më të mira as për Putinin në Evropë. Kryeministri hungarez lakeu i Rosisë, Viktor Orbán, u votua së fundmi jashtë detyrës pas 16 vjetësh në pushtet.

Presidenti serb Aleksandar Vuçiq, nga ana e tij, ka qenë duke lëvizur me kujdes për t'u mbrojtur: megjithëse Serbia në fillim dukej se mbështeste pushtimin e Ukrainës nga Rusia, Vuçiq që atëherë është takuar disa herë me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky dhe ka eksportuar municion me vlerë të paktën 908 milionë dollarë në Ukrainë përmes vendeve të treta (Bullgarisë, Republikës Çeke dhe Polonisë). Vuçiq gjithashtu ka anuluar

kontrata ushtarake me furnizuesit rusë të armëve, duke nënshkruar në vend të kësaj një marrëveshje prej 2.7 miliardë eurosh me Francën për 12 avionë luftarakë Rafale. Por Putini deri tani ka zgjedhur të mos reagojë.

Gjëja e fundit që i nevojitet është të konsolidojë humbjen e njerit prej aleatëve të tij të fundit të dukshëm në Evropë.

Ndërkohë, klienti i Putinit prej kohësh, presidenti bjellorus Aleksandër Lukashenko, ka liruuar të burgosur politikë në një përpjekje për të përmirësuar marrëdhëniet me Perëndimin—dhe madje ka pasur kontakt me presidentin amerikan Donald Trump.

Edhe pse “diktatori i fundit i Evropës” nuk po priset me Kremlinin, ai po përgatit një rrugë ikjeje—dhe po rrit edhe më shumë bastet.

Pastaj është Kina.

Përpara luftës në Ukrainë, Rusia dhe Kina paraqiteshin si dy fuqi të mëdha që i rezistonin dominimit perëndimor dhe lavdëronin “partneritetin e tyre pa kufij” pak para pushtimit. Por marrëdhënia sot duket më shumë si një martesë e pabarabartë për interes personal sesa një aleancë e dy palëve të fuqishme të barabarta. Kina i furnizon Rusinë me mallra me përdorim të dyfishtë, si mikroelektronikë dhe vegla pune—jo armë—ndërsa Rusia i shet Kinës naftë dhe gaz me çmim të zbritura.


Ndoshta miku më besnik i Rosisë sot është Koreja e Veriut, e cila vendosi më shumë se 10,000 ushtarë për të luftuar krah forcave ruse në rajonin Kursk, pas depërtimit të Ukrainës në Rusi në gusht 2024. Por edhe ky marrëdhënie është thelbësisht transaksional, i bazuar në pasiguri të përbashkët dhe armiqësi ndaj Perëndimit.

Putini besonte se pushtimi i Ukrainës do të rivendoste statusin e Rosisë si fuqi e madhe, do të gërryente ndikimin perëndimor dhe do të përshpejtonte kalimin drejt një rendi ndërkombëtar multipolar. Përkundrazi, ai ka shkatërruar besueshmërinë e Kremlinit si partner dhe aleat.

Rusia ende ka armë bërthamore, një vend të përhershëm në Këshillin e Sigurimit të OKB-së dhe rezerva të mëdha energjie, por lufta në Ukrainë e ka lënë atë të dobësuar rëndë dhe të paaftë për të ushtruar ndikim dhe për të formësuar çështjet botërore në asnjë mënyrë tjetër përveç kërcënimit me luftë. (Project Syndicate)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Sunderlandi mban Xhakën, Beshiktashi monitoron situatën

SUNDERLAND, 14 MAJ - Kapiteni Granit Xhaka pritet që edhe në sezonin e ardhshëm të jetë figurë kyçe te skuadra e Sunderlandit pavarësisht prej spekulimeve për të ardhmen e tij. Së fundmi është raportuar se skuadra nga Turqia, Beshiktashi, po

insiston në transferimin e Xhakës këtë verë, pasi e sheh 33-vjeçarin si përforcim ideal për mesfushën. Në fakt, sipas medimeve turke, Xhaka është duke shqyrtuar largimin nga Sunderlandi pas vetëm një sezoni edhe pse me ekipin anglez ka kontratë deri në verën e vitit

2028. Madje është thënë se Xhaka është i hapur për një kalim te Beshiktashi, pasi tashmë ka marrë referenca pozitive në lidhje me klubin, futbollin turk dhe Superligën e Turqisë. Në sezonin e tij të parë te Sunderlandi, Xhaka ka shënuar 1 gol dhe ka bërë 6 asistime në 32 paraqitje,

duke u shndërruar në lider të ekipit si brenda ashtu edhe jashtë fushës. Ai te Sunderlandi është transferuar verën e shkuar nga Bayer Leverkuseni, ndërsa karrierë ka bërë edhe tek Arsenali, Borussia Monchengladbachu dhe Baseli.



KFF DUKAGJINI FITON PËR HERË TË DYTË RADHAZI KUPËN E KOSOVËS

PRISHTINË, 14 MAJ - Skuadra e KFF Dukagjinit nga Klina ka triumfuar për të dytin vit radhazi në Kupën e Kosovës në konkurrencën e femrave. Ashtu si në edicionin e kaluar ndaj Mitrovicës, edhe këtë herë futbollistet klinase i janë gëzuar trofeut pas ekzekutimit të penalltive, duke e mposhtur kësaj radhe KFV Prishtinën me rezultat 5:4, pasi ndeshja në kohën e rregullt dhe pas vazhdimëve ka përfunduar baras 1:1. Finalja ka sjellë rivalitet të madh, emocione dhe luftë sportive deri në sekondat e

fundit. Dukagjini ka kaluar në epërsi qysh në minutën e 4 me golin e Olsa Kuçit, duke krijuar epërsi të hershme në finale. Megjithatë, prishtinaset nuk janë dorëzuar dhe kanë arritur ta rikthejë baraspeshën në minutën e 86, kur ka realizuar Rreze Gashi, duke e çuar sfidën në vazhdimë. Edhe gjatë 30 minutave shtesë të dy skuadrat kanë krijuar raste të mira shënimi, madje duke goditur edhe shtyllat, por pa arritur ta gjejnë golin e fitores. Në fund fituesi është përcaktuar nga penalltitë, ku më të sakta janë treguar

futbollistet e Dukagjinit, të cilat kanë triumfuar me rezultat 5:4 falë pritjes së portieres Lavdije Behrami në serinë e fundit të penalltive dhe ngritjen trofeun për të dytin vit radhazi. Pas përfundimit të ndeshjes, trofeun për kapitenen e Dukagjinit, Xhenifer Pjetri, e ka ndarë presidenti i FFK-së, Agim Ademi. Medaljet për ekipet finaliste janë ndanë nga anëtarja e Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, Vjollca Krasniqi, si dhe nga shefja e futbollit të femrave në FFK, Valbona Gashi Uka.



KLUBI I FUTSALLIT 'POLICIA E KOSOVËS' SHPALLET KAMPION I LIGËS SË PARË

PRISHTINË, 14 MAJ - Klubi i Futsallit "Policia e Kosovës" ka arritur një sukses të madh sportiv, duke u shpallur kampion i Ligës së Parë të Futsallit për edicionin garues 2025/2026 dhe duke siguruar pjesëmarrjen në gara në Superligën e Kosovës. Në njoftimin zyrtar është bërë me dije se ekipi i Policisë së Kosovës ka dominuar lojën duke fituar

me rezultat 8:3. Pas përfundimit të ndeshjes, në një atmosferë festive dhe emocionuese është zhvilluar ceremonia solemne e ndarjes së medaljeve dhe Kupës së Kampionit. Medaljet dhe trofeu i janë dorëzuar ekipit kampion nga kryetari i FFK-së, Agim Ademi dhe drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend

Hoxha, në praninë e zyrtarëve të lartë të Federatës së Futbollit të Kosovës, udhëheqjes së klubit Policia e Kosovës dhe Drejtorisë së Sportit të komunës së Prishtinës. "Policia e Kosovës shpreh mirënjohje për të gjithë ata që kanë mbështetur ekipin gjatë këtij rrugëtimi dhe uron që ky sukses të shërbejë si motivim për të gjithë. Urime dhe suksese ekipit!", ka njoftuar policia.

TREPÇA UDHËHEQ 2:0 SERINË FINALE TË "PLAY-OFF"-IT NDAJ BASHKIMIT

MITROVICË, 14 MAJ - Trepça ka fituar edhe një tjetër ndeshje të serisë finale "play-off"-it të elitës së basketbollit ndaj Bashkimit. Trepça dhe Bashkimi kanë shfaqur basketboll të nivelit të lartë edhe në ndeshjen e dytë të serisë finale. Trepça ka fituar me rezultatin 93:83 para tifozëve të vet të



zjarrtë, të cilët ishin në numër të madh në palestrën "Minatori" në Mitrovicë. Tani Trepça ka epërsi 2:0 në serinë finale të "play-off"-it, ndërsa tani ndeshjet barten në Prizren, përkatësisht në palestrën "Sezai Surroi". Ndeshja e parë ishte mbyllur me rezultatin 94:79, ndërsa dueli i tretë i finales luhet të dielën nga ora 19:30.

INTERI FITON KUPËN E ITALISË PËR HERË TË 10

ROMË, 14 MAJ - Interi vazhdon dominimin në futbollin italian. Pas titullit kampion në Serinë A, "nerazzurët" kanë fituar edhe Kupën e Italisë, duke mposhtur Lazion me rezultat 0-2 në finalen e zhvilluar në "Olimpico" të Romës. Skuadra zikaltër e ka zhbllokuar finalen falë një autogoli të Adam Marusic, derisa vulën e triumfit ia ka vendosur kapiteni Lautaro Martinez me golin e dytë. Interi ka treguar edhe një herë përvojën dhe forcën e skuadrës së

Simone Inzaghit, duke kontrolluar finalen dhe mos i lënë shumë hapësira Lazios, që kërkonte trofeun dhe një vend në Evropë. Për klubin nga Milano kjo është Kupa e 10 e Italisë në histori, ndërsa sezoni tashmë konsiderohet fantastik pas dy trofeve të mëdhenj të fituar.



PSG-ja shpallet kampione e Francës për herë të 14 në histori

PARIS, 14 MAJ - Paris Saint-Germain është shpallur zyrtarisht kampion i Francës për sezonin 2025/26, pasi ka mposhtur në udhëtim RC Lens me rezultat 0-2 në ndeshjen e

mbetur të javës së 29 të Ligës 1. Parisienët kanë vulosur matematikisht titullin, duke vazhduar dominimin absolut në futbollin francez. Golat e fitores për skuadrën e Luis

Enrique janë realizuar nga Khvicha Kvaratskhelia në minutën e 29, pas asistimit të Ousmane Dembele, ndërsa talenti i ri Mbaye ka shënuar golin e dytë në minutat shtesë

për të konfirmuar triumfin e PSG-së. Ky është titulli i 14 kampion në histori për klubin parisien, duke e forcuar edhe më shumë statusin si skuadra më e suksesshme në Francë.





SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita:	Analist i ri i të dhënave (2 pozita)
Niveli i gradës:	P07
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti:	Teknologjia e Informacionit dhe Sigurisë Kibernetike
Divizioni:	Menaxhimi i Databazave dhe Aplikacioneve
Raporton tek:	Udhëheqësit të Divizionit për Menaxhimin e Databazave dhe Aplikacioneve

Përgjegjësitë dhe detyrat e punës:

- Dizajnimi, zhvillimi dhe optimizimi i **skriptave në SQL Server**, përfshirë queries, views, stored procedures dhe tuning të performancës;
- Zhvillimi dhe mirëmbajtja e proceseve **ETL**, duke përdorur **SSIS**;
- Krijimi dhe mirëmbajtja e **raporteve dhe dashboard-ëve në Power BI**, përfshirë modelimin e të dhënave dhe DAX;
- Integrimi i të dhënave nga burime të ndryshme (database, file, API);
- Analiza e të dhënave dhe pastrimi, transformimi, automatizimi dhe vizualizimi i tyre;
- Zbatimi i teknikave të **Data Science dhe Machine Learning** (klasifikim, regresion, parashikim, detektim anomalish) për mbështetje të vendimmarrjes;
- Sigurimi i cilësisë, saktësisë dhe konsistencës së të dhënave;
- Bashkëpunimi me ekipet teknike dhe të biznesit për përkthimin e kërkesave në zgjidhje analitike.

Edukimi:

- Diplomë universitare në fushën e shkencave kompjuterike, elektroteknike apo matematikës.

Përvoja e punës:

- Të ketë së paku një (1) vit përvojë pune profesionale në fushën që ndërlidhet me përgjegjësitë e vendit të punës sipas këtij konkursi.

Njohuritë e kërkuara:

- Përvojë me **SQL Server** (T-SQL, query optimization, indexing, performance tuning);
- Përvojë praktike në **Data Science dhe Machine Learning**;
- Njohuri në **Power BI** (data modeling, DAX, dizajn vizual, optimizim performancë);
- Njohuri në **SSIS** për ETL dhe integrim të të dhënave;
- Njohuri në **Python** (Pandas, NumPy, libra për vizualizim dhe analizë);
- Aftësi analitike dhe vëmendje ndaj detajeve.

Njohja e gjuhëve të huaja:

- Rrjedhshmëri në të folur dhe në të shkruar të gjuhës shqipe dhe/ose serbe;
- Njohja e gjuhës angleze përparësi.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të **Formularit zyrtar të BQK-së** gjatë aplikimit online nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes;
- Kandidatët duhet të bashkëngjisin **letër përcjellëse (motivuese)**, e cila duhet të jetë e adresuar dhe e përgatitur posaçërisht **për pozitën për të cilën aplikojnë**; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim;
- Dëshmi mbi përvojën e punës**, që mbulojnë **së paku një (1) vit** përvojë pune (kopje të kontratave të punës, vërtetime nga punëdhënësi apo dokumente të tjera relevante që dëshmojnë pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, që mbulon **së paku një (1) vit** përvojë pune, ose, në rastet kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht, vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **01 qershor 2026**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.



OGLAS O SLOBODNOM RADNOM MESTU

Pozicija:	Novi analitičar podataka (2 pozicije)
Nivo stepena:	P07
Trajanje zaposlenja:	na neodređeno vreme
Odeljenje:	Informaciona tehnologija i kibernetička bezbednost
Odsek:	Upravljanje bazama podataka i aplikacija
Izveštava kod:	Rukovodioca Odseka za upravljanje bazama podataka i aplikacija

Odgovornosti i dužnosti rada:

- Dizajniranje, razvoj i optimizacija **skripti u SQL Server**, uključujući query optimization, indexing, performance tuning;
- Razvoj i održavanje **ETL** procesa, koristeći **SSIS**;
- Kreiranje i održavanje **izveštaja i dashboard-ova u Power BI-u**, uključujući modeliranje podataka i DAX;
- Integracija podataka iz različitih izvora (database, file, API);
- Analiza podataka i njihovo čišćenje, transformacija, automatizacija i vizualizacija;
- Primena tehnika **Data Science i Machine Learning** (klasifikacija, regresija, predviđanje, otkrivanje anomalija) za podršku donošenju odluka;
- Obezbeđivanje kvaliteta, tačnosti i konzistentnosti podataka;
- Saradnja sa tehničkim i poslovnim timovima za prevođenje zahteva u analitička rešenja.

Obrazovanje:

- Univerzitetska diploma iz oblasti nauke računarstva, elektrotehnike ili matematike.

Radno iskustvo:

- Da ima najmanje jednu (1) godinu profesionalnog radnog iskustva u oblasti koja se odnosi na odgovornosti na radnom mestu prema ovom konkursu.

Potrebno znanje:

- Iskustvo sa **SQL Serverom** (T-SQL, query optimization, indexing, performance tuning);
- Praktično iskustvo u **Data Science i Machine Learning**;
- Poznavanje **Power BI** (data modeling, DAX, dizajn vizual, optimizim performancë);
- Poznavanje **SSIS-a** za ETL i integraciju podataka;
- Poznavanje **Python** (Pandas, NumPy, knjige za vizualizaciju i analizu);
- Analitičke sposobnosti i pažnja na detalje.

Poznavanje stranih jezika:

- Tečno govorenje i pisanje albanskog i/ili srpskog jezika;
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.

Svi kandidati moraju poslati sledeće dokumente:

- Aplikacije sa nepotpunim i neispravnim popunjavanjem **služenog Obrasca CBK-a** tokom online apliciranja neće biti razmatrane i rezultirati diskvalifikacijom tokom procesa selekcije;
- Kandidati moraju priložiti **propратно pismo (motivaciono)**, koje mora biti adresirano i pripremljeno posebno **za poziciju za koju apliciraju**; u suprotnom, aplikacija neće biti razmatrana;
- Dokaz o radnom iskustvu**, koji pokriva **najmanje jednu (1) godinu** radnog iskustva (kopije ugovora o radu, potvrde poslodavca ili drugi relevantni dokumenti koji dokazuju radno mesto i radno iskustvo, bez kršenja relevantnih akata za zaštitu ličnih podataka);
- Izveštaj Kosovskog penzijskog štednog fonda (Trusti)** za relevantni period, koji obuhvata **najmanje jednu (1) godinu** radnog iskustva, ili, u slučajevima kada izveštaj Fonda nije zakonski primenljiv, poresku potvrdu Poreske administracije Kosova (PAK);
- Kopije diploma, dok diplome stečene izvan Republike Kosovo moraju biti službeno priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Procedura apliciranja:

- Krajni rok za apliciranje je **01 jun 2026. godine**.
- Apliciranje se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko službene internet stranice CBK-a. Ostali obrasci za apliciranje neće se razmatrati.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

